

Progetto cofinanziato da



UNIONE  
EUROPEA



ISTITUTO NAZIONALE  
SALUTE, MIGRAZIONI  
E POVERTÀ



MINISTERO  
DELLA SALUTE



MINISTERO  
DELL'INTERNO

Fondo Europeo per l'Integrazione dei cittadini di Paesi terzi

# INFORMASALUTE

## Shërbimi Shëndetësor Nacional per Shtetasit e Huaj jo Komunitar



# INFORMASALUTE

---

**Shërbimi Shëndetësor Nacional  
per Shtetasit e Huaj jo Komunitar**



## **UDHËZUES MBI SHËRBIMIN SHËNDETESOR NACIONAL**

Regjistrimi me detyrim .....	5
Regjistrimi me dëshirë (vullnetar) .....	6
Shërbimi Shëndetësor Nacional .....	8
Libreza shëndetësore .....	8
Mjeku i familjes .....	9
Mjeku i rojes - Kujdes i vazhdueshëm i shërbimit shëndetësor .....	10
Ilacet .....	10
Vizitat tek specialistet dhe analizat .....	11
Spitalet .....	11
Urgjencat (Ndihma e shpejte) .....	12
Mos pagimi i vizites (tiket) .....	13
<b>FAQ – Pyetje me frekvente</b> .....	14

## **SHËNDETI TEK GRATE**

### **Te drejta te barabarta per të gjitha gratë ne bote**

Konsultore familjare .....	21
Mbrojtja ne shtatezani .....	22
Femija juaj .....	22
Deshtimi o aborti .....	23
Kontraceptimi .....	24
Parandalimi dhe diagnostikimi i tumoreve femerore .....	25
Menopauze .....	27
Te drejtat themelore te gruas dhe femijes .....	27
Permbledhje .....	30



# UDHEZUES MBI SHËRBIMIN SHËNDETËSOR NACIONAL

Shtetasit e huaj jo komunitare me leje qëndrimi të rregullt, si dhe familjarët që ka në ngarkim dhe që janë me dokumenta të rregullta në Itali, kanë të drejtë të regjistrohen në Shërbimin Shëndetësor Nacional (SSN) dhe të trajtimit të barabartë me shtetasit italian për sa i përket pageses edhe ndihmes së dhënë. **Regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Nacional mund të jetë i detyrueshëm ose vullnetar** dhe ka kohëzgjatje të njëjtë me atë të lejes së qëndrimit.

## KUJTOHU QE

*Ligji italian njih te drejten mbi shëndetin si te drejtë themelore te individit. Shtetasit e huaj që jetojnë ne itali dhe janë me dokumenta te rregullta kanë trajtim te njejte, dhe barazi të plotë me shtetasit italianë. Regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Nacional garanton shërbim të plotë shëndetësor me të njejtë te drejta me shtetasit italiane.*

## Marrëveshje integrimi

Nga data 10 mars 2012, i huaji që vjen në Itali për herë të parë në momentin e aplikimit të lejes së qëndrimit për një periudhë jo më pak se një vit, është bere një marrëveshje integrimi me Shtetin. Marrëveshja zgjat për dy vjet dhe qëndrimi do të vlerësohet me pikë. Sporteli Unik për emigracionin do të marrë në shqyrtim dokumentet e paraqitura në rast të hyrjes për motiv pune o për bashkim familjar, dhe në vazhdimësi. **Regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Nacional gjithashtu dhe në zgjedhjen mjekut të përgjithshëm japin te drejten drejtë e marrjes te 4 pikëve.**

## Regjistrimi me detyrim

Qytetarët e huaj që kanë te drejten dhe përbushin kriteret të përcaktuara nga ligji janë të detyruar të regjistrohen në Shërbimin Shëndetësor Nazional. Regjistrimi i detyrueshëm, i quajtur edhe **regjistrimi me detyrim**, i garantohet te huajit për motive pune, motive familiare, mbrojtje huamnitare, në pritje të nenshtetësisë, të kujdestarisë ose birësimi (adoptimi). Më konkretisht, tipologjitë e lejeve të qëndrimit që japin të drejtën e regjistrimit të detyrueshëm në (SSN) Shërbimit Shëndetësor Nacional janë:

- Pune të pavarur e pune të varur (edhe sezonale), që janë të regjistruar në Zyrën e Punës (nelle liste di collocamento), në pritje për punësim
- Arsyje familjare, kohezionit familjar, bashkimi familjar (me përjashtim të

## Udhëzuesi mbi sherbimin shëndetësor nacional

prindërve që kanë mbi gjashtedhjetë e pese vjet që ka ardhur me bashkim familjar për të cilin është i parashikuar regjistrimi me dëshire) (vullnetar)

- Kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare dhe Konventa e Dublinit
- Statusi i refugjatit (azil politik)
- Mbrojtjes susidiare
- Mbrojtje humanitare (i cili mund të jepet për arsye shëndetësore të moshës, situata të rënda politike, dhuna apo mos respektimi i te drejtave të njeriut, varferie ose fatkeqesitë natyrore etj...)
- Në pritje të birësimit (në këtë rast fëmijes nuk i është lëshuar asnjë leje

qendrimi, por ai gëzon të njëjtat të drejta të të miturit italian)

- Besimi për rritje/afidamenti
- Te miturit që kanë nevojë për kujdes shëndetësor
- Kujdesi mjekësor që ju jepet grave shtatzëna deri në gjashtë muaj paralindjes dhe pas lindjes së fëmijës për tju siguruar sherbimin shëndetësor
- Ju sigurohet sherbimi shëndetësor, shtetasve të huaj në qofte se kanë marrë zgjatje të lejes së qëndrimit në rast sëmundje ose aksident në punë
- Te burgosurit dhe të internuarit
- Marrja e nenshtetësisë italiane

6

### Ne cilën Njesi shëndetësore ASL duhet të regjistrohem?

*Duhet të besh regjistrimin në Njesinë ASL të Komunes ku keni lejen e banimit, në qofte se ankoma nuk e keni lejen e banimit mund të regjistroheni në ASL-in me të afert pranë vendbanimit aktual. Për vendbanim aktual merret në konsideratë adresa që është vendosur në lejen e qëndrimit.*

Kujdesin shëndetësorë e gezojnë edhe familjarët që keni në ngarkim, që kanë leje qëndrimi të rregullt dhe jetojnë në Itali.

## Regjistrimi me dëshire

Regjistrimi me dëshire (vullnetar) mund tju behet shtetasve të huaj jo komunitar që kanë leje qëndrimi me vlefshmeri me teper se tre muaj dhe që **nuk kanë të drejtë të regjistrimit me detyrim në Sherbimin Shëndetësor Nazional**, hyjne këto kategori:

- Studentet
- Titullaret e lejes së qëndrimit për vendbanimin e zgjedhur
- Personat që punojnë "alla pari"
- Bashkim familjar me prinderit mbi 65 vjeç
- Fetaret

- Nenpunesit e huaj qe punojne ne Itali, ne organizatat internacionale, duke perjashtuar akordet internacionale
- Personeli i akredituar tek perfaqesuesit diplomatik dhe ne zyrat e konsullates
- Puntoret qe nuk jane te detyruar te paguajne tatimin qe korrispondon ne Itali me te ardhurat mbi fitimin
- Te huajt qe marrin pjese ne nje program vullnetariati
- Studiuessit qe ndodhen me qellimi të kerkimeve shkencore
- Te gjitha kategorite qe nuk bejne pjese ne regjistrimin me detyrin në shërbimin shendetesor te detyrueshëm dhe kane një leje qëndrimi për më shumë se tre muaj

Regjistrimi vullnetar i nënshtrohet pagesës së taksës vjetore dhe mund ti behet edhe familjarëve që shtetasi i huaj ka ne ngarkim, dhe i referohet vitit kalendarik (e vlefshme nga 1 janari deri me 31 dhjetor) dhe nuk mund të ndahet.

Për të huajt që qendrojnë **për motiv studim** dhe për **personat** me të drejta bë nejta është llogaritur mbi bazën e përgjitheshme.

*Studentet dhe te huajt qe punojne “alla pari”, mund te regjistrohen me deshire ne Sherbimin Shendetesor Kombetar edhe pse qendrojne ne territorin italian per nje periudhe me pak se tre muaj. Kane mundesine te paguajne nje shume te paket, e te kerkojne te regjistrohen per nje periudhe me pak se nje vit.*

**Vini re:** Për të bërë regjistrimin e familjareve ne ngarkim, studentët dhe personat te barazvlefshëm duhet të paguajnë plotësisht kontributin.

*Shtetasit e huaj që vijnë per kura mjekesore sipas art. 36 T.U. (ose ata qe kane hyre ne Itali me vize te rregullt per kura mjekesore) nuk mund te regjistrohen ne Sherbimin Shendetesor Kombetar.*



## Shërbimi Shendetesor Nacional

**SSN** është sigla e **Sherbimi Shendetesor Nacional**, ose me mire e sherbimit shendetesor publik. Per te patur sherbimet shendetesore te shendetesise publike duhet te regjistrohesh ne Sherbimin Shendetesor Nacional. Regjistrimi ne SSN behet ne **ASL**

### **Kujtohuni: Duhet te paraqisni lejen e qendrimit dhe kodin fiskal**

*Libreza shendetesore duhet te kerkohet nga i interesuari, ose nga persona te tjere qe jane te deleguar me kopjen e dokumenti njohjeje te personit te interesuar. **Ne rast se e humbisni librezën shendetesore.** Mund te kerkosh duplikat duke paraqitur pervec dokumentit edhe autocertifikimin ose kopien e denuncimit per humbjen e dokumentit qe keni bere tek autoritetet kompetente.*

(Njesia Shendetesore Lokale) qe ndodhet me afer vendit ku ju keni vendbanimin, ose ku banoni aktualisht; praktika zakonisht behet ne nje zyre, ose prane nje sportelli, qe quhet “zgjedhja dhe nderrimi i mjekut”. Ne te njejtin vend gjeni listen me emrat e te gjithë mjekeve,

ku mund te zgjidhni mjekun ose/dhe pediatrin per femijen tuaj. Punonjesi do t’ju leshoje **librezën shendetesore** qe ka te njejten date scadenze me ate te lejes se qendrimit.

## Libreza shendetesore

Libreza shendetesore është një dokument qe leshohet ne momentin e regjistrimit ne SSN dhe lejon perdorimin e sherbimeve qe ofron sistemi shendetesor italian. Ne librezën shëndetesore jane te regjistruara kodi i identifikimit, emri juaj si dhe emri i mjekut te familjes. Karta shendetesore ka te njejten skadenze te lejes se qendrimit: per ta përtëritur, duhet te paraqitni ne (ASL)

dokumentat qe tregojne qe juve keni bere kërkesen per ta rinovuar lejen e qendrimit.

### **Jeni ne pritje te leshimit te Lejes se pare te Qendrimit per pune te mvarur ose per motive familjare?**

*Mund te regjistroheni ne SSN ne baze te dokumentave qe vertetojne kerkesen e lejes se qendrimit.*

*Nese ju jeni te regjistruar me te drejte ne SSN dhe jeni duke pritur rinovimit e lejes se qendrimit mund të mbani regjistrimin ne SSN.*

**Kujdes.** Ju mund te perfitonni sherbimet shendetesore vetem duke paraqitur librezën shendetesore.

## Zgjedhja e Mjekut te pergjithshem ose Pediatri

Regjistrimi ne SSN jep te drejten dhe zgjedhjen e mjekut te pergjithshem (mjekun e familjes), ose pediatri per femijet deri ne 14 vjec qe jane me leje qendrimi te rregullt,

### **Me ka ardhur ne shtepi nje librezhe shendetesore magnetike, zevendeson librezhen shendetesore te stampuar ne leter?**

*Librezha shendetesore magnetike nuk zevendeson librezhen shendetesore prej letre, duhet te ruhet me kujdes spese mbart emrin e mjekut te familjes, ose pediatri, dhe vizitat qe mund te beni pa pagese.*

dhe garanton vizitat pa pagese ne klinike dhe ne shtepi, leshimin e ilaceve dhe kerkesen e vizitave tek specialisti.

Mjeku i pergjithshem dhe pediatri mund te jene te zevendesueshem ne cdo kohe.

## Mjeku i familjes

Cdo person qe eshte i regjistruar ne SSN ka te drejte te kete mjekun e familjes, i quajtur edhe **mjeku baze** ose **mjeku i pergjithshem**.

Zgjedhja e mjekut te familjes behet ne zyrat e ASL ku banoni (ose ku qendroni aktualisht) ne te cilin beni regjistrimin ne SSN, ne listen e mjekëve te territorit. Per femijet deri ne moshen 14 vjec duhet te zgjidhni nje **pediater**, ne te njejten menyre per zgjedhjen e mjekut te familjes. Mjeku dhe pediatri i bazes jane shume te rëndësishem per shendetin tuaj. Ato kane si detyre qe te bejne diagnostikimin dhe te japin kuren e duhur. **Zgjedhja e mjekut te familjes ose pediatri, mund te modifikohet ne cdo moment.**

Cdo mjek i familjes dhe pediater, i zgjedhur nepermjet ASL, ka nje ambulator dhe duhet te garantoje **falas** vizitat e bera tek mjeku i pergjithshem, ne oraret dhe ditet e vendosura. Duhet te shkoni tek mjeku edhe per:

- Raport mjekesor per puntoret e mvarur
- Raport per te shkuar ne shkolle
- Kerkesa te vizitave te specializuara dhe tekste diagnostike
- Kerkesa per shtrim ne spital jo ne raste urgjenze
- Kerkesa per kure reumatizme (lligja)
- Leshim ilacesh

## Vizitat në shtëpi

*Ne rast nevojë mjeku i familjes, ose pediatri, mund t'ju bëjë vizite mjekësore në shtëpinë tuaj. Vizita në shtëpi behet kur pacienti nuk është në gjendje të shkojë në ambulator për të bërë vizitën.*

**Te gjitha këto shërbime behen falas.**

## Mjeku i rojes - Kujdes i vazhdueshëm i shërbimit shëndetësor

Mjeku i rojes është një shërbim falas i asistencës shëndetësore dhe kërkohet nepermjet telefonit në rastë urgjence kur nuk është e mundur që të kontaktohet mjeku juaj i familjes ose pediatri.

Shërbimi funksionon **në orët e natës dhe në ditë festash**. Kur ju merrni në telefon ju përgjigjet një mjek që ju jep këshilla se çfarë duhet të bëni dhe ju bën një vizitë mjekësore në shtëpi në qoftë se është e nevojshme. Pas vizitës dhe pas kurave të momentit, mjeku i rojes mund të leshojë ilaçe, mund të japë raportin që jeni i semurë, mund t'ju këshillojë të shtroheni në spital.

## Kini Kujdes

*Numri telefonik i Mjekut të rojes ndryshon nga qyteti në qytet. Shiko gjithmone listen telefonike të vendit ku ndodhesh.*

## Ilacet

Ilacet e leshuara nga mjeku që ju kuron mund t'i gjeni në farmaci.

Disa nga ilacet hyjnë në kategorinë e ilaceve “salva-vita” dhe janë falas, ose pagesa e një kontributit të vogël (il **tiket**); ilaçe të tjera nuk janë në ngarkim të SSN dhe paguhet shuma e plote. Në farmaci gjinden edhe ilacet të ashtuquajtura “farmaci da banco” që mund të merren me pagesë dhe pa recete.

**Në vendin ku jetoni do të gjeni gjithmone një farmaci të hapur si në orët e natës dhe në ditët e festave. Te gjitha farmacitë vënë në dukje orarët dhe turnet e të gjitha farmacive të zonës.**

## Vizitat tek specialistet dhe analizat

Mund të keni asistencë specialiste dhe të bëni vizita radiologjike në laborator me anë të **recetes**, dmth me recetën e plotësuar nga mjeku i familjes ose pediatri. Asistenca specialiste ose në ambulator bëhet nepermjet prenotimit, duke paraqitur recetën dhe librezën shëndetësore në sportelet e spitalit ose në ambulator, aty ku do të bëni vizitën duke kontaktuar zyrtarët e CUP (Qendra e Vetme e Prenotimit). **Per cdo vizite specialiste paguhet tikit**, duke përjashtuar raste të veçanta për të cilat nuk bëhet pagesë.

**Kujtohuni gjithmone të respektoni takimin!**

*Ne rast se nuk keni mundësi mund të anuloni takimin.*

## Spitalet

Spitalet në Itali mund të jenë **publike** ose **private**.

Për tu shtruar është e domosdoshme që mjeku i familjes të leshojë fletën e shtrimit, në rast urgjence shtrimi në spital mund të leshohet nga mjeku i urgjencës.

Shpenzimet e shtrimit në spital mbulohen nga SSN.

### **Kujtoni që**

*Personli mjekësor ju informon mbi rreziqet që mund t'ju sjell nderhyrja kirurgjike, anestezia, etj. Mbi trajtimin ndryshimet dhe alternativat e mundshme. Perpara se te operoheni ju jepet te firmosni **Consenso Informato**.*

Ne spitalet publike nuk jeni të detyruar të paguani as në formë parash as dhuratash që janë personale (mjekut, infermiereve dhe teknikeve etj...).

### Urgjencat (Ndhima e shpejte)

118

118 eshte nje sherbim publik falas i ndihmes se shpeje shendetesore dhe eshte aktiv 24 ore mbi 24. Numri i telefonit eshte **118** dhe mund te telefononi vetem ne raste urgjente duke kerkua ndihmen e shpejte. Nderhyrja e 118 nuk zevendeson sherbimin e dhene nga **mjeku i familjes** ose te **mjeku i rojes - sherbim i vazhdueshem shendetesor**.

Ne momentin qe telefononi 118 kujtohu qe te:

- komunikoni emrin tuaj, mbiemrin dhe nje numer telefoni
  - Pershkruani urgencen qe keni
  - Specifiko adresen ku mund tju
- dergohet ndihma e shpejte: rrugen, numrin e shtepise, lokalitetin ose ndonje pike referimi

12

### Ndhima e shpejte

Ne rast urgjence shendetesore (aksident, situata rreziku per jeten) mund te shkoni ne Urgjencen e spitalit me te afert. Ne Urgjence ju japin menjehere ndihmen e shpejte si me ilace edhe me sherbim mjekesore.

**Paralajmerim:** Vizitat ne Urgjence nuk behen sipas kohes se arritjes, por duke vleresuar gjendjen shendetesore dhe simptomat nga personeli qe pret pranimin e pacienteve.

#### Mos harroni!

*Urgjenca eshte nje sherbim ne te cilen ju mund te shkoni kur jeni ne situacione urgjence. Per te gjitha kerkesat shendetesore qe juve keni, dhe qe jane te rendesishme por jo urgente mund te shkoni tek mjeku juaj (ose tek mjeku roje ne oraret kur mjeku juaj nuk eshte i disponueshem) per te bere vizitat specialistike qe eshte e nevojshme leshimi i recetes nga mjeku.*

### Hyrja ne Urgjence

Ne urgjenze mund te shkoni individualisht, ose pasi te keni aktivizuar 118.

Ne **Hyrje** personeli shendetesor ju jep nje **kod-me ngjyre qe jep prioritetin** per te siguruar sherbimin dhe asistencen e menjehereshme personave qe jane ne rrezik per

jeten dhe per te rregulluar dhe sistemuar neper ambulatorie sipas gjendjes shendetesore dhe sipas orarit te ardhjes.

### **Mos pagimi i vizites (tiket)**

**Tiket** eshte nje tarife pagimi qe behet per Sherbimet Shendetesor Publike. Te gjithë shtetasit i nenshtrohen pageses se tiket per sherbimet e specializuara, pervec te perjashtuareve. Pagimi i tarifes duhet te behet perpara se te behet vizita, ne sportelet e administrates se ambulatorit ose te spitalit.

Ne disa raste (invalided, te semuret kronike dhe me aftesi te kufizuara, te ardhurat ose moshë) nuk behet pagesa e tarifes se stabilizuar ne sherbimin shendetesor. Per te patur me shume informacione mbi mospagesen e tarifes, dhe per leshimin e certifikates ose librezes te mospagimit, mund te drejtoheni Zyres qe eshte kompetente per perjashtimin nga tarifa te Njesise Shendetesore Lokale - ASL.

## FAQ ▸ Pyetje me frekvente

### Kam Lejen e Qendrimit per motiv Pune (nen vartesi ose sezonale).

#### Cilet jane dokumentat qe duhet te paraqes per tu regjistruar ne SSN?

- ▀ Lejen e Qendrimit ose ricevuta e kerkeses per rinovim
- ▀ Dokument identifikimi
- ▀ Kodin Fiskale
- ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim (N.B. Kohezigjatja e librezes shendetesore SSN ka te njejten kohezigjatje te PDS)

### Kam ardhur ne Itali me vize te rregullt sipas dekretit - fluksit dhe po pres leshimin e Lejes se Qendrimit te pare.

#### Cilet jane dokumentat qe duhet te paraqes per tu regjistruar SSN?

- ▀ Ricevuta qe verteton qe ju keni prezantuar kerkesen per leshimin e Lejes se Qendrimit.
- ▀ Fotokopia e dokumentit nulla-osta (mospengesa) e leshuar nga Sportelet Unike per Imigrimin
- ▀ Kopia e kontrates se qendrimit e nenshkruar nga Prefektura
- ▀ Dokument identifikimi
- ▀ Kodin Fiskal
- ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim

### Ndodhem rregullisht per Pune te Pavarur.

#### Cilat jane dokumentat qe duhet te prezantoj per tu regjistruar ne SSN?

- ▀ Lejen e Qendrimit, ose ricevuta e kerkeses per rinovim
- ▀ Dokument identifikimi
- ▀ Partita IVA ose pozicionin INPS
- ▀ Kodin Fiskal
- ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim

### Jam i regjistruar ne Zyren e Punes dhe kam lejen e qendrimit ne pritje per punesim.

#### Kam te drejte te regjistrohem ne sherbimin shendetesor te detyruar te SSN?

- Po, ne momentin qe shkoni per te bere kerkesen e leshimit
- kerkesen duhet te prezantoni ne ASL:
- ▀ Dokument identifikimi
- ▀ Lejen e Qendrimit, me ricevuta dhe
- ▀ Kodin Fiskal

- ▶ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim
- Per te kerkuar **perjashtimin nga**

**pagimi i tarifës shendetesore** per te adhurat, duhet te jeni i regjistruar ne listen e Zyren e Punes

## **Kam Lejen e Qendrimit per Motive Familjare.**

### **Cilat jane dokumentat qe une duhet te paraqes per tu regjistruar ne SSN?**

- ▶ Lejen e Qendrimit, ose faturate kerkeses te rilasacio/rinnovo
- ▶ Dokument identifikimi
- ▶ Kodin Fiskal
- ▶ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim

## **Jam ne pritje te leshimit te lejes se qendrimit te pare per bashkim familjar.**

### **Cilat jane dokumentata qe duhet te paraqes per tu regjistruar ne SSN?**

- ▶ Ricevuta qe deklarone kerkesen e leshimit te Lejes se Qendrimit
- ▶ Fotokopia e nulla-osta (mospenges) e leshuar nga Sporteli Unike per Imigrimin
- ▶ Dokument identifikimi
- ▶ Kodin Fiskal
- ▶ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim

## **Cilat jane dokumentat qe duhet te paraqes per te regjistruar ne SSN prinderit e mi mbi moshen 65 vjec, qe ka hyre ne Itali me vize per bashkim familjar?**

- ▶ Prindit i takon regjistrimi me deshire ne SSN, duhet te paraqisni ne ASL:
  - ▶ Lejen e Qendrimit ose ricevuten e rinovimit
  - ▶ Dokument identifikimi
  - ▶ Kodin Fiskal
- ▶ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim
- ▶ Kopja e pageses te kontributit (pagesa behet ne poste dhe faturen per te bere pagimin duhet ta merrni ne zyrat e ASL)



### Jam nje shtetas i huaj dhe kam lejen e qendrimit per kohezion familjar. Kam te drejte per regjistrimin e detyrueshem ne SSN?

- Po, duhet te paraqitesh ne ASL:
- ▀ Lejen e Qendrimit, ose kerkeses per rinovim
  - ▀ Dokument identifikimi
  - ▀ Kodin Fiskal
  - ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim

### Jam shtetas i huaj me leje qendrimi te rregullt, femija im ka lindur ne Itali. Cilet dokumenta me duhen per ta regjistruar ne SSN?

- ▀ Certifikata e lindjes
- ▀ Kodi Fiskal i te porsalindurit

### Kam Lejen e Qendrimit per strehim politik/mbrojtje humanitare o protezione sussidiaria. Cilet jane te drejtat e mia mbi kujdesin shendetesor?

- Regjistrimi ne sherbimin shendetesor eshte e drejta jote; duhet te paraqisni ne ASL:
- ▀ Lejen e Qendrimit ose ricevuta e rinovimit
  - ▀ Dokumentin e identifikimit
  - ▀ Kodin Fiskal
  - ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim

### Kam kerkuar Strehim Politik– Mbrojtje nderkombetare ne Itali. Cilet jane te drejtat e mia mbi kujdesin shendetesor?

- Per tu regjistruar ne SSN duhet te shkoni ne ASL te vendit ku juve ndodheni:
- ▀ Lejen e Qendrimit ose ricevuta e rinovimit
  - ▀ Kodin Fiskal
  - ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim

Kerkuesit per strehim politik, dhe mbrojtje nderkombetare, jane te **perjashtuar nga pagesa e tarifes** (duke deklaruar situaten ekonomike) deri ne muajin e gjashte qe ka bere kerkesen e strehimit politik. Pas muajit te shtate kerkuesit e

strehimit politik kane te drejten per te punuar dhe gjendja e te qenurit i papune komunikohet me ane te regjistrimit ne Zyren e Punes dhe ne ASL per leshimin e certifikates per mospagesen e tiket ne baze te te ardhurave.

### **Kam Lejen e Qendrimit ne pritje per rimarrjen e nenshtetesis italiane. Cilet jane dokumentat, qe duhet te paraqes per tu regjistruar ne SSN?**

- ▀ Lejen e Qendrimit ose ricevuta e rinovimit
- ▀ Kodin Fiskal
- ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim

### **Jam kujdestari i nje femije (te mitur) qe ka Lejen e Qendrimit nen moshe. Cilet jane dokumentat qe duhen per te bere regjistrimin ne SSN?**

- ▀ Lejen e Qendrimit ose ricevuta e rinovimit
  - ▀ Dokumenti i identifikimit
  - ▀ Kodin Fiskal
  - ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit ,ose autoçertifikim
- te nenshkuar nga kujdestari
- Ne raste se femija (i mituri) po pret qe te marre Lejen e Qendrimit te pare per nenmoshe, duhet te paraqes edhe kopien e dekretit te mirebesimit ose te para-biresimit.

17

### **Kam nisur praktiken per adoptim te nje te mituri qe jeton me mua. Cilat jane dokumentata qe me duhen per tu regjistruar ne SSN?**

- ▀ Dokumentin e miratuar per adoptimin ose te pregatitjes te para-biresimit
- ▀ Dokumenti i identifikimit
- ▀ Kodin Fiskal
- ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit ,ose autoçertifikim te nenshkuar nga kujdestari

### Jam kujdestari (tutore) i nje femije te cilit i eshte leshuar Leje Qendrimi per Mirëbesim. Cilet jane dokumentat qe duhet te paraqes alla ASL per regjistrimin ne SSN?

- ▀ Lejen e Qendrimit ose ricevuta e rinovimit
  - ▀ Dokumenti i identifikimit
  - ▀ Kodin Fiskal
  - ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit ,ose autoçertifikim
- te nenshkuar nga kujdestari
- Ne rast se femija eshte ne pritje per te marre Lejen e Qendrimit te pare si minoren, duhet te paraqes edhe nje kopje te dekretit te kujdestarise o te mirebesimit para-adoptimit.

### Cilet jane dokumentat per regjistrimin ne SSN te te miturve (femijeve) qe jane me leje qendrimi per sherim psiko-fizike?

- ▀ Dokument qe deklarone kujdestarine e perkoheshme ne baze te programeve te solidaritetit
- ▀ Dokumenti i identifikimit
- ▀ Kodin Fiskal
- ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit ,ose autoçertifikim te nenshkuar nga kujdestari

18

### Ndodhem me Leje Qendrimi per kurim/kujdes mjekesor dhe per shtatezani. Cfare dokumentash duhet te paraqes per tu regjistruar ne SSN?

- ▀ Lejen e Qendrimit ose ricevuta e rinovimit
- ▀ Dokumenti i identifikimit
- ▀ Kodin Fiskal
- ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim

### Te burgosurit e huaj mund te perdorin sherbimet shendetesore publike?

- ▀ Te gjithë te burgosurit e huaj kane te drejte dhe jane te detyruar te regjistrohen ne SSN pergjate periudhes se burgimit, **qe kane apo nuk kane lejen e qendrimit te vlefshme**, duke perfshire edhe te burgosurit me gjysem liri edhe ata qe i neshetrohen masave alternative te denimit.
- Te burgosurit jane te perjashtuar nga pagesa e tarifës (tiket) te vizites.

## Ndodhem me dokumeta te rregullta dhe kam Lejen e Qendrimit per motive te Drejtesise. Mund te regjistrohem ne SSN?

Keni te drejte dhe jeni i detyruar te regjistroheni ne SSN. Duhet te paraqisni ne ASL:

- ▀ Lejen e Qendrimit ose ricevuta e

rinovimit

- ▀ Kodin Fiskale
- ▀ Çertifikatë e residencës, deklaratë efektive e banimit, ose autoçertifikim

## Ndodhem rregullisht per motiv studimi.

### Kam te drejte te regjistrohem në sherbimin shendetesor?

Po, mund te regjistrohesh me deshire ne SSN. Regjistrimi **eshte individual**, duhet ti nenshtroheni pageses se nje **Kontributi fiks vjetor** perfshihen edhe familjaret e tu nese ju i keni ne ngarkim me cmime te ndryshme.

**Kujtoniqe:** Ne qofte se je ne ngarkim te nje famijari per nje nga motivet qe vendosin regjistrimin me detyrim ne SSN, keni te drejte te regjistroheni ne SSN..

19

## Jam nje puntore ne nje familje me te nejtin nivel con Leje Qendrimi.

### Kam te drejte te kem sherbimin shendetesor?

Mund te zgjidhni te regjistroheni me deshire ne SSN, qe eshte i vlefshem ne territorin nacional. Regjistrimi me deshire ne SSN **eshte**

**individual** duhet ti nenshtroheni pagese te nje **kontributi vjetor** perfshihen edhe familjaret e tu nese ju i keni ne ngarkim me nje cmim te ndryshem.

# SHENDETI TEK GRATE

## Te drejta te barabarta per të gjitha gratë

*Ligji italian garanton te drejtat e cdo gruaje, italiane ose te huaj, ne sherbimin shendetesor, ekonomik dhe social, mbeshetjet psikologjike dhe te drejta te barabarta ne trajtim ne pune. SSN ju siguron te gjitha grave nderhyrjet parandaluese, per sa i perket kujdesine ne shtatezani, kujdesine per femijen, vaksinimin, diagnostikimin dhe kurimin nga semundjet infektive.*

Konsultori familjar eshte vendi i pare ku jepet sherbimi shendetesor dhe social. Eshte nje sherbim shendetesor dhe social publik, ka funksionime parandalimin, informimin dhe edukimin social, shendetesore dhe psikologjik, duke perdorur profesionist te kualifikuar ne nivele te ndryshme.

### Konsultore familjare

20

Konsultori familjar eshte sherbim shendetesor-social publik qe tutelon dhe promovon shendetin mendor-fizik dhe social te gruas, te bashkeshorteve, te adoleshenteve dhe femijeve.

Ju mund te shkoni ne konsultor per cdo problem qe i perket:

- Kontraceptimit
- Shatezenesia
- Kujdesi pas lindjes dhe mbeshetja e te ushqyerit me gji
- Vaksimini
- Aborti
- Keshillat mbi lindjen
- Parandalimi mbi tumoret
- Edukimi afektiv dhe seksual
- Shqetesime nga ushqimet
- Ndermjetesime familjare ne rast ndarjeje
- Fertiliteti/Steriliteti
- Ngarkim dhe adoptim
- Dhuna dhe keqtrajtimi, si ne gra edhe ne femije
- Mbeshetjet bashkeshorteve ose famijes ne kushte sociale-ekonomike te renda
- Gjendje psikologjike ne momente te vecanta (adoleshenteve, shtatzanesise, pas lindjes, etj.)
- Semundjeve te marra nepermjet raporteve seksuale
- Menopauza
- Keshilla ligjore

Personeli i konsultores eshyte i pregatitur dhe perbehet nga operator te specializuar: mjek gjinekolog, psikolog, mamite, punonjes shendetesor, punonjes social, avokat. Konsultori eshte nje sherbim qe kryen sherbimet falas dhe eshte i hapur per te gjithë; punon ne bashkepunim me spitalin e me te gjithë sherbimet e terretoret (shkollen, komunat, shoqatat).

*Hyrja ne Konsultoren familjare eshte e lire dhe nuk ju kerkohet qe te keni autorizim nga mjeku. Mund te shkoni edhe pa patur orar takimi, per te folur me nje nga personelet qe do tju fiksoj nje orar, ne qofte se eshte e nevojshme, per te bere viziten.*

*Sherbimet e ofruara nga konsultori jane falas, pervec ndonje vizite tek gjinekologu per te cilen eshte e parashikuar pagesa e (tarifes) tiket.*

## Mbrojtja ne shtatezani

Te gjitha grate qe jetojne ne Itali, kane te drejten mbi tutelimin per shtatzani. Nese jeni shtatzene mund ti drejtoheni mjekut te familjes ose konsultorit me te afert; qe te perfitosh asistencen e shtatzanise, qe parashikon shoqerimin e gruas, qe nga momentet a para te shtatzanise, me ane te ketyre sherbimeve:

**1 Asistence ne shtatzani:** vizita gjinekologjike, ekografi, kontrole dhe analiza me mjete shendetesore, kurse pergatitjeje per lindje dhe konsulent legal per grate qe punojne.

**2 Asistence gjate lindjes:** asistence gjate lindjes, edukim dhe mbeshtetje per dhenjen e qumeshtit dhe kurat e para te femijes.

**3 Asistence pas lindjes:** ne vecanti vizitat pas lindjes

## Femija juaj

Pas lindjes, mamija leshon nje certifikate per asistencen gjate lindjes, e dobishme per te regjistruar te sapolindurin ne listen e komunes (anagrafe). Regjistrimi duhet bere brenda 10 ditesh pas lindjes, ne zyrat e gjendjes civile te Komunes ose brenda 3 ditesh pas lindjes, ne drejtorine sanitare te spitalit.

Deri ne 6 vjet femija ka te drejten te beje gratis, vizita, analiza laboratorit dhe kontrole te tjera, nese te ardhurat e familjes nuk kalojne shumen e vendosur nga shteti. Nese keni veshtiresi sociale-ekonomike mund ti drejtoheni asistentit social.

### Vaksinimet

Shendeti i femijes duhete te tutelohet ne cdo moment te jetes. Vaksinimi eshte menyra me efikase per te parandaluar semundjet infektive dhe pasojat e tyre. Ne Itali disa vaksina jane te **detyrueshme per ligj**: antidifterica, antitetanica, antipolio, antiepatite B; disa te tjera jane **fakultative por keshillohen te behen**. Eshte e keshillueshme ti drejtoheni **Pediatrit** per te marre informacione dhe drejtimin e duhur. Mund te merrni te gjitha informacionet e duhura mbi **vaksinimin e detyrueshem** nga konsultori i familjes.

22

### Regjistrimi i Porsalindurit ne SSN

*Njeri nga prinderit duhete te shkoje ne ASL i pajisur me dokumentit e identiteti, per te autocertifikuar te dhenat e te porsalindurit, qe do te regjistrohet ne SSN. Te porsalindurit do ti jepet nje kod shendetesor personal dhe pediatri i zgjedhur nga lista e mjekeve te ASL-it.*

### Kujto!

*Femija qe ka filluar te beje ciklin e vaksinimit ne vendin e lindjes mund te vazhdoje programin e vaksinimeve ne konsultorin perkates te familjes; eshte e keshillueshme qe te prezantoheni me certifikaten qe tregon vaksinimet e bera.*

## Nderprerje e vullnetshme e shtatzanise (IVG)

Ligji italian parashikon mundesine per te nderprere vullnetarisht shtatzanine brenda 90 ditesh nga fillimi i menstruacioneve te fundit. Nese, pasi te keni vleresuar te gjitha mundesite, vendosni te abortoni, mund te drejtoheni te nje konsultor, ku gjinekologu ju leshon certifikaten e duhur per te bere abortimin (kete certifikate mund ta leshoje dhe gjinekologu i besueshem, mjeku i familjes ose ndonje tjetere specialist. Keshtuqe do te jeni i lidhur me reupartet e duhura per te bere operacionin.

### Kujtohu qe!

*Konsultori garanton takime dhe konsultime per te hequr motivet qe kane cuar ne vendosjen per abort. Garanton asistence psikologjike, informacione mbi shoqata vullnetarësh dhe shoqata e sherbimeve sociale.*

### **Nuk mund te mbaje femijen por nuk dua te abortoje**

*Ligji italian njej te drejten e lindjes anonime (nuk deklarohen te dhenat dhe nuk jepet asnje dokument) dhe mosnjohja e femijes, duke garantuar ne te njejten kohe femijes te drejten qe te rritet ne familje. Nuk konsiderohet shkelje ligji dhe nuk senjalizoheni organeve te policise dhe nuk merrni gjobe. Pasi te kete lindur, prindi mund te lere te sapolindurin ne spital dhe ka 10 dite kohe per ta rinjohur; nese nuk e njej atehere i porsalinduri eshte i adoptueshem dhe i jepet familjes qe eshte ne krye te listes per adoptim. Eshte nje zgjedhje pas se ciles nuk mund te kthehesh mbrapsht.*

## **Kontraceptimi**

Nje event i rendesishem sic eshte lindja e femijes duhet te jete dhe i deshiruar dhe i programuar me shume siguri dhe bindje. Sot egziston mundesia te zgjedhesh ne menytrat e kontrceptimit me te pelqyeshmin nga femrat ose kopja, mbi te gjitha lejon kopjen te jetoje ne menyre me te qete dhe me te sigurte intimitetin.

23

### **Menytrat naturale te kontrceptimit**

Lejone dallimin e periudhes kur femra eshte fertile dhe mund te jene te dobishme per te evituar ngeljen shtatzene, si edhe per femrat qe duan te ngelen shtatezена. Llogaritja e periudhes fertile mund te behet ne menyra te ndryshme dhe jo gjithmone eshte e sakte, sepse cikli tek femrat nuk ka data te sakta; per kete, menytrat naturale te kontrceptimit nuk jane shume efikase.

**Raporti seksual me nderperje** konsiderohet menyre naturale e kontrceptimit sepse nuk parashikon perdormini e substancave ose mjeteve, por eshte pak efikase per parandalimin e shtatzanise dhe te semundjeve seksuale.

### **Kujto!**

*Efikasiteti i kontrceptiveve eshte ne parandalimin e shtatzanise. Personeli shendetesor ne konsultorin e familjes mund t'ju ndihmoje ne zgjedhjene kontrceptiveve me te pershtatshem. Perdorimi i kontrceptiveve shmang ngeljen ne shtatzeni te padeshirueshme dhe lirshmerine ne vendosjen me deshire te ngelurit shtatzene.*



### Cilat menyra kontrceptivi jane te disponueshme ne Itali?

- ▶ **Pilula**, ose kontrceptivi hormonal, parandalon shtatzanine duke bllokuar ovulimin dhe modifikuar funksionalitetin lokal te mukoses se uterus dhe te tubave. Eshte shume efikase dhe duhet te merret me shume kure.
- ▶ **Fascia** aplikohet ne pjese te ndryshme te trupit. Duhet te nderrohet cdo jave.
- ▶ **Unaza** vaginale eshte e holle, transparente dhe elastice. Aplikohet ne vagine dhe duhet nderruar nje here ne muaj.
- ▶ **Preservativi** ose condomi, eshte nje membrane e holle e perbere prej gome, duhet aplikuar ne penisin e mashkullit qe te mbledhe spermen duke e moslejuar te derdhet ne vagine. Nuk te mbron nga semundjet seksuale.
- ▶ **Preservativi femeror** eshte nje membrane e holle dhe rezistente qe aplikohet ne vagine perpara raportit seksual. Per parandalimin nga shtatezania infeksjoneve dhe semundjeve seksuale
- ▶ **Kontrceptimi i injektuar** eshte nje injeksion muskolar, mujor ose tremuaj dhe ka efekt nga nje deri ne tre muaj. Nuk parandalon semundjete seksuale
- ▶ **Spiralja** eshte nje objekt i vogel plastike qe futet ne miter nga gjinekologu, femra nuk e ndjen prezencen e spirales as gjate raportit seksual. Nuk mbron nga semundjet seksuale.

### Nese keni pasur nje raport seksual qe perben rrezik shtatzanie

*Duhet te shkoni sa me pare te mundeni tek mjeku i familjes, ne konsultorin familjar, ose ne urgjence, per konsulenze dhe per leshimin e nje receteje per kontrceptivin ne raste urgjente. Ky kontrceptiv, quhet kontrceptivi i dites se neserme dhe ka si efet parandalimin e shtatzanise pas nje raporti te pambrojtur.*

*Nuk mbron nga semundjet seksuale dhe nuk provokon abort nese jeni shtatzene.*

## Parandalimi dhe diagnostikimi i tumoreve femerore

Sherbimi shendetsor italian rakomandon te gjitha grave, italiane dh te huaja, berjen e kontrolleve per parandalimin dhe diagnostikimin e tumoreve femerore. Studime te ndryshme klinike dhe statistikat nacionalekane dimostruar qe tumoret e qafes se mitres dhe te gjoksit mund te sherohen nese diagnostikohen ne kohe. Mund ti drejtoheni Konsultorit Familjar qe te besh kontrolllet qe te propozojne: **pap-test** cdo tre vjet per grate nga mosha **25 deri 64 vjec**, per te parandaluar dhe diagnostikuar ne kohe tumoret ne qafen e mitres; **mammografia** cdo vit per grate nga mosha **45 deri 49 vjec** dhe cdo dy vite per grate nga mosha **50 deri 74 vjec**, per diagnostikimin ne kohe te tumorit te mamografise.

Ne shume Rrethe eshte e mundur te behet pa pagese programi i screening per parandalimin e tumorit te qafes se mitres dhe per diagnostikimin ne kohe te mamografise.

### Perse screening keshillohen te behen nga grate qe i perkasin nje fashe te percaktuar moshë?

*Pap-testi ne moshen nga 25 deri 64 vjec eshte efikas per te dalluar nje carje qe mund te shkaktoje tumor ne qafen e mitres, dmth qe mund te prek dhe membranat me te thella. Nje grua pas moshes 64 vjec, qe ka bere rregullisht pap-test, shfaq rrezik me te ulet per tumor ne thellesi. Neqoftese nuk ka bere asnjehere, dhe pse nuk ka moshen per te bere screening, dhe pas moshes 64 vjec duhet te beje testin te pakten nje here. Mammografia eshte analiza me e besueshme per diagnostikimin e tumorit ne gjoks sepse nxjerr ne pah dhe carjet me dimensione shume te vogla; eshte e keshillueshme per moshat nga 45 deri 74 vjec sepse eshte fasha e moshes me me rrezik.*

25

### C'fare eshte Pap-test?

Pap-test eshte nje kontroll eshte nje analize shume e dobishme per diagnostikimin ne kohe te nje tumori dhe per carjet para-tumori tek cervice uterina. Konsiston **ne marrjen** ne menyre delikate te qelizave te qafes se mitres, qe me pas do te analizohen me mikroskop. Tumori i qafes se mitres zhvillohet shume ngadale dhe nuk dallohet nga vizita gjinekologjike. Nuk jep shenje prania e tij per shume kohe por eshte shume i rrezikshem nese nuk dallohet dhe kurohet ne kohe.

### **C'fare eshte mamografia?**

Mamografia eshte nje analize radiologjike e gjoksit dhe eshte analiza me efikase per diagnostikimin ne kohe te tumorit.

Tumori i mameles eshte nje semundje shume e shpeshte tek femrat qe jetojne ne vendet oksidentale te industrializuara dhe eshte shkasi i pare i vdekjes se femrave. Aktualisht tumori i mameles mundet te zbulohet ne kohe dhe sherimi mund te arrihet pa qene e nevojshme te hiqet mamela.

### **Menopauze**

Menopauza nuk eshte nje semundje, eshte nje moment fiziologjik normal, qe shenjon ne jeten e nje femre, fundin e moshes fertile. Rrjedhoja me e dukshme eshte fundi i menstruacioneve.

Mosha mesatare kur fillon menopauza eshte nga 43 deri 53 vjec. Kur ben pjese ne kete fashe, skeletri fillon te dobeshet dhe shfaqen rreziqe te osteoporosi dhe rritet rreziku i semundjeve vaskulare dhe tumori ne gjoks. Eshte e rendesishme qe te mbani nen kontroll shendetin duke ju drejtuar mjekut te familjes ose konsultorit.

26

### **Te drejtat themelore te gruas dhe femijes**

Ligji italian respekton principin e perkatjes te cdo personi ne origjinen e prejardhjes kulturele, religjose, familjare dhe komunitare. Denon cdo forme dhune dhe cdo sjellje dhe kulturele qe demton integrimin fizik dhe psikologjik te personit, perfshire praktikat tradicionale te demshme per femrat dhe femijet si per shembull martesat e parakohshme ose e forcuar edhe mutilacionet e gjenitaleve femerore (MGF).

### **C'fare eshte MGF?**

MGF eshte heqja totale ose e pjesshme, e organit femeror te jashtem, qe eshte e praktikuar per motivi kulturele ose fetare ose per arsye te tjera jo-terapike. Egzistojne menyra te ndryshme te MGF me nivel te ndryshem demtimi, qe mund te jene prerja e klitorides deri ne infibulacion (heqja e te gjithes ose vetem nje pjese e organeve gjenitale te jashtme dhe mbyllja e hapjes vaginale).

### Ligji mbi MGF

*Te gjithë organizatat internacionale te te gjitha vendeve, oksidentale ose africane ose asiatike, jane dakord ne perkufizimi e MGF si dhune e integritetit fizik, psiqik dhe moral tek femrat dhe si shkelje shume e rende e njerës nga te drejtat themelore qe eshte e drejta e shendetit.*

***Ne Itali MGF eshte krim dhe ndeshkohet me burg.*** Ligji n. 7 me 9 gennajo 2006 parashikon burgim nga 4 deri 12 vjet per ke praktikon mutilacionet ne menyre jo terapike dhe me qellimin me qellimin qe te modifikoj funksionet seksuale, ngritja e denimit ne nje te trete kur viktima eshte minorene. Autori denohet dhe kur opreacioni behet jashte vendit nje neshtetase italiane ose te huaj por qe ka vendbanimin ne Itali.

### Numri falas 1522

1522 eshte numer publik i dobishem **aktiv 24 ore mbi 24 pergjate 365 ditësh ne vit dhe gratis** ne te gjithë territorin nacional dhe asistena telefonike e specializuar ne degjimin dhe ne analizen e kerkeses eshte ne gjuhe te ndryshme. Sherbimi jep te dhena dhe orjenton per qendrat e kunder dhunes, per sherbimet sociale-shendetesore, per policine, per sherbimet private sociale qe ndodhen ne territor per te ndihmuar, per mbrojtjen dhe mbeshtetjen per daljen nga dhuna.

### Kujto!

*Shume shoqeri fermrash imigrate ne Itali jane te impenjuara ne aktivite per parandalimin dhe uljen e MGF dhe mbeshtesin grate me ane te grupeve qe mbeshtesin dhe lehtesojne bashkepunimin me sherbimet socio-shendetesore. Per cdo problem shendetesor mund ti drejtoheni Konsultori Familjare.*

## Permbledhje

Azienda Sanitaria Locale (ASL)	Njësia Shëndetësore Lokale
Centro per l'Impiego (CPI)	Zyra e punës
Codice fiscale	Kodi i identifikimit
Consultorio familiare	Konsultori familjar
Contracezione	Kontraceptim
Domicilio effettivo (o effettiva dimora)	Deklarate efektive e banimit (ose autocertifikim i qëndrimit aktual)
Tessera di esenzione dal pagamento del ticket	Deklaratë që vërteton përjashtimin nga pagesa e tarifës
Interruzione Volontaria di Gravidanza (IVG)	Ndërpreje e Shatëzanisë së Padëshiruar
Iscrizione obbligatoria	Regjistrimi me detyrim
Iscrizione volontaria	Regjistrimi me dëshirë (vullnetar)
Mammografia	Mamografi
Medico di famiglia (medico di base o medico di medicina generale)	Mjeku i familjes (mjeku familjar ose mjeku i përgjithshëm)
Menopausa	Menopauza
Mutilazioni Genitali Femminili (MGF)	Mutilim gjenital femëror
Nulla osta	Leje (bashkim familjar)
Pap-test	Pap-test
Partita IVA	Kodi TVSH
Pediatra	Pediatër
Permesso di soggiorno	Leja e qëndrimit
Acquisto cittadinanza	Marrja e nënshtetësisë
Affidamento	Birësim
Asilo politico	Azil politik
Attesa adozione	Në pritje të adoptimit
Attesa occupazione	Në pritje për punësim
Coesione familiare	Kohezion familjar
Cure mediche	Kurë mjekësore
Lavoro autonomo	Punonjës autonom

Lavoro subordinato	Punonjës te mvarur
Motivi familiari	Motiv familjar
Protezione internazionale	Mbrojtje internazionale
Protezione sussidiaria	Mbrojtje e perkohshme
Protezione umanitaria	Mbrojtje humanitare
Ricongiungimento familiare	Bashkim familjar
Persona collocata alla pari	Persona te barazvlefshëm
Posizione INPS	Pozicioni INSIG
Prefettura	Prefektura
Residenza anagrafica	Zyra e gjendjes civile
Servizio di continuità assistenziale (guardia medica)	Shërbim i vazhdueshëm mjekësor (mjeku i rojës)
Servizio Sanitario Nazionale (SSN)	Shërbim Shëndetësor Nacional
Sportello Unico per l'Immigrazione (SUI)	Sporteli Unik për Imigracionin
Tessera sanitaria	Librezë shëndetësore
Testo Unico per l'Immigrazione (TU)	Teksi Unik mbi Emigracionin (TU)
Ticket	Tiket (tarifë)
Ufficio Relazioni con il Pubblico (URP)	Zyra për marrëdhënie me publikun
Vaccinazione	Vaksinat
Visite e prestazioni specialistiche	Vizitat dhe shërbimet e specializuara

**INMP**

Istituto Nazionale Salute, Migrazioni e Povertà  
Via di San Gallicano 25/a Roma  
info@inmp.it - www.inmp.it

**MINISTERO DELLA SALUTE**

[www.salute.gov.it](http://www.salute.gov.it)